



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, 04 maj 2020
Nr. Ref.:RK 1557/20

VENDIM PËR REFUZIM TË KËRKESËS

në

rastin nr. KI201/19

Parashtrues

Tush Kolgjeraj

**Kërkesë për rishqyrtimin e Aktvendimit për papranueshmëri KI127/18,
të 21 tetorit 2019, të Gjykatës Kushtetuese**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Tush Kolgjeraj, nga fshati Zym, Komuna e Prizrenit (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin për papranueshmëri nr. KI127/18, të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata), të 21 tetorit 2019.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes së kësaj kërkesë në të vërtetë ka të bëjë me kërkesën e parashtruesit për rishikimin e pretendimeve të tij të ngritura në kërkesën e mëparshme KI127/18.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës], 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji).

Procedura në Gjykatë

5. Më 11 nëntor 2019, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
6. Më 12 nëntor 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu Krasniqi (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Radomir Laban.
7. Më 19 nëntor 2019, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës.
8. Më 22 prill 2020, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës që të refuzojë kërkesën me procedurë të shkurtër.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 31 gusht 2018, parashtruesi i kërkesës kishte dorëzuar kërkesën nr. KI127/18. Në atë kërkesë, parashtruesi kishte kërkuar vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit PN.nr.825/17 të 6 tetorit 2017.
10. Më 21 tetor 2019, Gjykata shpalli kërkesën nr. KI127/18 të papranueshme.
11. Më 11 nëntor 2019, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën nr. KI201/19, me ç' rast kërkoi "rishqyrtim" të Aktvendimit për papranueshmëri nr. KI127/18.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

12. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata, duke shpallur kërkesën e mëparshme të tij KI127/18 të papranueshme, si të paafatshme, "vërtetoi shkeljet" që i janë shkaktuar atij me vendimet e gjykatave të rregullta, duke

pretenduar se “Aktvendimi i Gjykatës Kushtetuese përkatësisht përmbajtja e tij është e papranueshme ngase është në shpërputhje me të vërtetën”.

13. Në fund, parashtruesi përsëriti pretendimet e tij siç i kishte ngritur në kërkesën KI127/18, duke kërkuar nga Gjykata që ta prishë vendimet e gjykatave të rregullta për arsye se siç thekson ai janë “*padrejtësi e manipulantëve gjyqësor e administrativ ne gjykatat tona*”.

Pranueshmëria e kërkesës

14. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
15. Përkitazi me këtë, Gjykata i referohet rregullit 35 (5) të Rregullores së punës, që përcakton:

“Gjykata mund të refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër, ... nëse kërkesa është përsëritje e një kërkesë të mëparshme të vendosur nga Gjykata ose ...”.

16. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës, në të vërtetë, përmes kërkesës së tanishme kërkon nga Gjykata që t’i marrë sërish në konsideratë pretendimet e tij të ngritura në kërkesën e mëparshme KI127/18.
17. Gjykata në kërkesën e mëparshme KI127/18 të parashtruesit të kërkesës, pasi vlerësoi kërkesën, erdhi në përfundim së kërkesa duhej deklaruar e papranueshme sepse ishte dorëzuar jashtë afatit ligjor.
18. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron se kërkesa e tanishme nuk paraqet ndonjë rrethanë të re për t’u rikonsideruar nga Gjykata. Për të gjitha çështjet e ngritura në këtë kërkesë, Gjykata tashmë ka vendosur në rastin KI127/18. Andaj, Gjykata konsideron se kërkesa e tanishme nuk paraqet asnjë provë a rrethanë të re për t’i rishikuar pretendimet e parashtruesit të ngritura në kërkesën e mëparshme KI127/18, për të cilat Gjykata vendosi me Aktvendim për papranueshmëri, më 21 tetor 2019 (shih, ngjashëm me këtë situatë, Vendimin për refuzim të kërkesës të Gjykatës Kushtetuese në rastin KI26/14, me parashtrues *Bajrush Gashi*, të 26 marsit 2015, paragrafi 24).
19. Në mënyrë që Gjykata të shqyrtojë një kërkesë që ndërlidhet me të njëjtat fakte sikurse kërkesa e mëparshme, parashtruesi duhet që me të vërtetë të ofrojë informata të reja që më parë nuk janë shqyrtuar nga Gjykata (Shih, *mutatis mutandis*, GJEDNJ, *Kafkaris kundër Qipros*, ankesë nr. 9644/09, Vendim për papranueshmëri, i 21 qershorit 2011, paragrafi 68).
20. Gjykata, rikujton se, ankimi individual sipas kuptimit të nenit 113.7 të Kushtetutës, nuk duhet të shikohet nga parashtruesit e kërkesës si mundësi për të kërkuar në mënyrë të përsëritshme nga Gjykata rishikimin e pretendimeve apo rihapjen e vendimeve për çështjet për të cilat Gjykata ka vendosur njëherë.

21. Për më tepër, Gjykata rikujton se vendimet e saj janë vendime të formës së prerë dhe të detyrueshme për gjyqësorin, për të gjithë personat dhe për të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës (shih, ndër të tjera, Vendimet e Gjykatës Kushtetuese, rastin KI26/14, parashtues *Bajrush Gashi*, Vendim për hedhje poshtë të kërkesës të 26 marsit 2015, paragrafi 26 dhe 27; rastin KIo8/18, parashtues *Naser Berisha*, Vendim për Refuzim të Kërkesës i 29 majit 2018, paragrafi 23).
22. Si përfundim, Gjykata konsideron se kërkesa e tanishme e parashtuesit të kërkesës, në fakt, është përsëritje e një kërkesë të mëparshme të vendosur nga Gjykata. Prandaj, në pajtim me rregullin 35 (5) të Rregullores, kjo kërkesë duhet të refuzohet me procedurë të shkurtër.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, të nenit 20 të Ligjit dhe rregullit 35 (5) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 22 prill 2020, njëzëri

VENDOS

- I. TË REFUZOJË kërkesën me procedurë të shkurtër;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Bekim Sejdiu

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi

